



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

KOMUNIKATË SQARUESE  
PËR MEDIA

21 prill 2021  
Prishtinë

Reagim sqarues ndaj Lajmeve për padinë e ngritur kundrejt Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.

Oda e Mjekëve të Kosovës e ka ndjekur me shqetësim publikimin e lajmeve për sa i përket padisë së bërë kundrejt Ministrisë së Shëndetësisë, Qeverisë së Kosovës. Padia është paraparë që në përmbajtje të ketë problematikën e mospagesës së shtesave në paga për të gjithë punëtorët shëndetësor gjatë kohës së pandemisë.

Sqarojmë opinionin publik se padia për shtesa është dorëzuar në Gjykatë me datë 03 mars 2021 dhe përmes saj është paditur Ministria e Shëndetësisë, e udhëhequr nga ministri paraprak z. Armend Zemaj, ndërsa tani për këtë proceduarë është njoftuar ministri aktual z. Arben Vitija.

Mjekët janë ata që kanë dhënë gjithçka nga vetja e tyre për t'u përballur me COVID-19, madje kanë sakrifikuar edhe familjet e tyre për ta mundur këtë sëmundje vdekjeprurëse. Mjekët janë ata që kanë qëndruar me përkushtim maksimal në vijën e parë të frontit. Andaj edhe publikimi i keqinterpretuar i një lajmi të tillë ngre shqetësime nga ana e stafit mjekësor të cilët përballen me probleme të natyrave nga më të ndryshmet.

OMK i bënë thirrje mediave për publikimin e lajmeve në mënyrën e saktë dhe jo të marrjes së vëmendjes në forma të tilla, që janë papërshtatshme dhe të papranueshme. Kjo sidomos kur dihet se OMK është dhe ka qenë çdo herë e hapur ndaj mediave dhe çdo herë në respektim të punës së palodhshme të gazetarëve në këtë kohë pandemi. OMK çdo herë ka vlersuar dhe falemderuar mediat për punën e palodhëshme në sensibilizimin e opinionit në këtë kohë pandemie dhe përqimin e mesazhit të punëtorëve shëndetësor gjatë kësaj periudhe

OMK qëndron fort prapa zbatimit të ligjeve, por edhe në ngritjen e zërit dhe ndërmarrjen e veprimeve në mbrojtjen e Mjekëve të Kosovës dhe vlerëson lartë angazhimin dhe punën e secilit punëtorë shëndetësor.

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdu, m. Sci